


## NJËSIA 2

### Barazia

**A je ti më i barabartë  
se unë?**



#### **2.1. Ndryshimet dhe ngjashmëritë**

A jam unë i barabartë? A jam unë ndryshe?

#### **2.2. Rrëfimi i Xhevahires**

Si do të reagonim po të na ndodhte kjo neve?

#### **2.3. Barazia në mes të meshkujve dhe femrave**

Si duhet t'i trajtojmë meshkujt dhe femrat?

#### **2.4. Drejtësia shoqërore**

Si duhet të përballemi me padrejtësitë?

## NJËSIA 2: Barazia

### A je ti më i barabartë se unë?

Barazia si koncept pranon se çdokush, pa dallim moshe, seksi, gjinie, feje, prejardhje etnike etj., duhet të gëzojë të drejta të njëjta.

Preambula e Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut fillon me fjalët “njohja e dinjitetit të qenësishëm dhe të drejtave të barabarta e të patjetërsueshme të gjithë anëtarëve të familjes njerëzore është themeli i lirisë, drejtësisë dhe paqes në botë”. Koncepti i qytetarisë nuk mund të veçohet nga çështjet e barazisë. Ekzistimi i pabarazive brenda ose në mes të shoqërive pengon qytetarinë e vërtetë. Ndaj, ideja e barazisë është në qendër të edukimit për qytetari demokratike. Si e tillë, ideja e barazisë merret me çështje të barazisë dhe duhet tu jep mundësi individëve që të veprojnë kundër të gjitha formave të diskriminimit.<sup>6</sup>

Diversiteti nënkupton lëvizjen përtej idesë së tolerancës në një respektim të vërtetë të vlerësimit të ndryshimit. Ky është thelbësor për idenë e pluralizmit e multikulturalizmit, dhe si i tillë është gurthemel i EQD Prandaj, EQD-ja duhet të përfshijë mundësi për të kontrolluar perceptimet dhe për të sfiduar anësinë dhe stereotipizimin. Duhet gjithashtu të synojë që të sigurojë lartësimin dhe pranimin e ndryshimeve brenda komuniteteve lokale, kombëtare, regjionale dhe ndërkombëtare.<sup>7</sup>

Në shumë mënyra, solidariteti mund të kuptohet si aftësi e individëve që të lëvizin përtej mundësi të tyre dhe të njohin e të jenë të gatshëm të veprojnë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të tjerëve. Qëllim kryesor i EQD-së është po ashtu pajisja e individëve me njohuri, shkathtësi dhe vlera që atyre u nevojiten për të jetuar plotësisht në komunitetet e tyre ashtu siç duhet. Siç u tha edhe më herët, veprat e solidaritetit janë të lidhura ngushtë me idenë e veprimit. Megjithatë, solidariteti është drejtim i mendimit po aq sa është edhe model i sjelljeve.<sup>8</sup>

Paragjykimi është vlerësimi që e bëjmë për një person tjetër ose njerëz të tjerë pa i njohur ata në të vërtetë. Paragjykimet mund të jenë me karakter negativ dhe pozitiv. Ato mësohen si pjesë e procesit të shoqërorizimit dhe shumë vështirë mund të ndryshohen apo çrrënjosen. Prandaj, është e rëndësishme që të jemi të vetëdijshëm për ekzistimin e tyre.

Diskriminimi mund të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejt ose jo të drejtpërdrejt. Diskriminimi i drejtpërdrejt karakterizohet nga synimi për të diskriminuar një person apo grup, siç është një zyrë punësimi që refuzon një kandidat rom, apo një firmë banesore që nuk u lëshon banesa me qira imigrantëve. Diskriminimi jo i drejtpërdrejtë përqendrohet në efektin e një politike apo mase. Kjo ndodh kur një masë, kriter apo praktikë, neutrale në dukje, vë një person ose një minoritet të caktuar në situatë në fakt të pafavorshme krahasuar me të tjerët. Mund të radhiten shembujt nga kushti për gjatësinë trupore minimale të zjarrfikësve (që mund të përjashtojë kandidatet femra më shumë se ata meshkuj), në dyqanet e mëdha që nuk punësojnë njerëz me funde të gjatë, ose zyrtat qeveritare apo normat shkollore që ndalojnë hyrjen apo pjesëmarrjen e njerëzve që mbajnë shami koke. Këto rregulla, me sa duket neutrale për sa i përket prejardhjes etnike apo fesë, mund të dëmtojnë në mënyrë të pabarabartë pjesëtarët e grupeve të caktuara minoritare apo fetare që mbajnë funde të gjatë ose shami koke.<sup>9</sup>

Termi “gjini” i referohet roleve të ndërtuara në marrëdhëniet shoqërore të meshkujve e femrave që u ngarkohen atyre në bazë të seksit. Kështu, rolet gjinore varen nga një kontekst i veçantë shoqëroro-ekonomik, politik apo kulturor dhe ndikohen nga faktorë të tjerë përfshirë këtu racën, prejardhjen etnike, klasën, orientimin seksual dhe moshën. Rolet gjinore mësohen, dhe ndryshojnë shumë brenda dhe ndërmjet kulturave. Për dallim prej seksit biologjik të një personi, rolet gjinore mund të ndryshojnë.<sup>10</sup>

6. Nga “Fjalori i termave të edukimit për qytetarisë demokratike” (“A glossary of terms for education for democratic citizenship”), Karen O’Shea, Këshilli i Evropës, DGIV/EDU/CIT (2003) 29.

7. Po aty.

8. Po aty.

9. Po aty.

10. Po aty.

Të drejtat ekonomike dhe shoqërore kanë të bëjnë kryesisht me kushtet e nevojshme për zhvillimin e plotë të individit dhe sigurimin e një standardi adekuat jetësor. Të quajtura shpesh “gjenerata e dytë” e të drejtave të njeriut, këto të drejta janë më të vështira për t’u zbatuar, pasi që konsiderohen të jenë të varura nga resurset që janë në dispozicion. Ato përfshijnë të drejtat siç është e drejta për të punuar, e drejta për tu edukuar, e drejta për kohë të lirë dhe e drejta për një standard adekuat jetese. Këto të drejta janë paraqitur ndërkombëtarisht në Konventën mbi të Drejtat Ekonomike dhe Sociale, e cila u adoptua nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara, më 1966.<sup>11</sup>

Njerëz të ndryshëm kanë opinione e qëndrime të ndryshme për atë se si shoqëria jonë duhet të merret me çështjet e drejtësisë shoqërore. Këto opinione dhe qëndrime mund të ndahen gjerësisht në tri kategori:

- Darwinistët, që mendojnë se individët janë plotësisht përgjegjës për problemet e tyre dhe duhet të merren vetë me ta. Ata besojnë se njerëzve ju duhet nxitje për të provuar me këmbëngulje. Darwinistët tentojnë të qëndrojnë jashtë arenës së politikës shoqërore.
- Dashamirësit, të cilët ndiejnë keqardhje për ata që vuajnë dhe duan të bëjnë diçka për të lehtësuar dhimbjen e tyre. Ata i shohin të drejtat sociale dhe ekonomike si objektiva të dëshiruara politike, më tepër sesa të drejta të njeriut. Kjo, shpesh, rezulton me një qasje mbështetëse për njerëzit që jetojnë në kushte të vështira sociale.
- Kërkuesit e drejtësisë, të cilët janë të shqetësuar për trajtimin jo të drejtë të njerëzve, kryesisht për shkak të vendimeve të qeverisë. Ata besojnë se duhet të ndërrojnë sistemin politik dhe ekonomik, në mënyrë që njerëzit të mos jenë të detyruar të jetojnë në varfëri.<sup>12</sup>

11. Nga “Fjalori i termave të edukimit për qytetarësh demokratike” (“A glossary of terms for education for democratic citizenship”), Karen O’Shea, Këshilli i Evropës, DGIV/EDU/CIT (2003) 29.

12. Marr nga “Duties sans Frontières. Human rights and global social justice”, Këshilli Ndërkombëtar i Politikave për të Drejta të Njeriut.

## NJËSIA 2: Barazia

### A je ti më i barabartë se unë?

Titulli i mësimit	Objektivat e mësimit	Detyrat e nxënësve	Burimet	Metoda
Mësimi 1: Dallimet dhe ngjashmëritë	Nxënësit mund të shpjegojnë barazitë dhe dallimet në mes të njerëzve.  Nxënësit vlerësojnë barazinë edhe dallimin.	Nxënësit gjejnë dallimet dhe ngjashmëritë në mes të njerëzve.  Nxënësit diskutojnë për disa nga pasojat e të qenit ndryshe.	Fletore ose fletë të letrës dhe stilolapsa për punë individuale. Aktiviteti shtesë është sipas dëshirës, por grupeve do tu nevojiten fletë të mëdha të letrës dhe shënues (markera) nëse mësuesi i përdorë ato.	Punë individuale dhe në grupe të vogla.
Mësimi 2: Tregimi i Xhevahires	Nxënësit vetëdijesohen për paragjykimet dhe diskriminimin në shoqëri. Nxënësit janë të aftë të kuptojnë pikëpamjet e viktimave të diskriminimit.	Nxënësit diskutojnë për një rast të diskriminimit dhe këtë e krahasojnë me situatën në shtetin e tyre.	Sipas dëshirës, një kopje e prospekteve të nxënësve 2.1.	Punë në grupe e bazuar në tekst.
Mësimi 3: Barazia në mes të meshkujve dhe femrave	Nxënësit janë të aftë të reagojnë ndaj situatave të diskriminimit.	Nxënësit gjykojnë se si ata, dhe shoqëria në tërësi, i trajtojnë gratë.	Kopje e një tregimi nga prospektet për nxënës 2.2 për çdo grup me katër apo pesë nxënës.	Punë në grupe të vogla.
Mësimi 4: Drejtësia shoqërore	Nxënësit vetëdijesohen për diskriminimin në baza gjinore në shoqëri.	Nxënësit diskutojnë çështje për ndarjen e drejtësisë. Nxënësit mendojnë sërish për tërë njësinë.	Kopje të prospekteve për nxënës 2.3, me ndarje të veçanta për çdo çift të nxënësve (sipas dëshirës).	Punë në çifte, të menduarit kritik.

**Mësimi 1****Dallimet dhe ngjashmëritë****A jam unë i barabartë? A jam unë ndryshe?**

<b>Objektivat e mësimnxënies</b>	Nxënësit mund të shpjegojnë barazitë dhe dallimet në mes të njerëzve. Nxënësit vlerësojnë edhe barazinë edhe dallimin.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Nxënësit i zbulojnë dallimet dhe ngjashmëritë ndërmjet njerëzve. Nxënësit diskutojnë për disa pasoja të të qenit ndryshe.
<b>Burimet</b>	Fletore ose fletë dhe stilolaps për punë individuale. Aktiviteti shtesë është sipas dëshirës por grupeve do t'ju nevojiten fletë të mëdha të letrës dhe shënues (markera) nëse mësimdhënësi i shfrytëzon ata
<b>Metodat</b>	Punë individuale dhe në grupe të vogla. Diskutim plenar

## Mësimi

Nxënësit formojnë grupe me katër apo pesë nxënës. Çdo grupi i nevojitet një copë letër dhe një stilolaps.

Mësimdhënësi u shpjegon se do t'u shtrojë një sërë pyetjesh në të cilat nxënësit duhet të përgjigjen po ose jo. Për t'u përgatitur për këtë, nga nxënësit kërkohet që të shënojnë shkronjat A deri në R horizontalisht, sipas renditjes alfabetike, duke lënë hapësirë të mjaftueshme poshtë. Mësimdhënësi mund ta bëjë të njëjtën në dërrasën e zezë.

<i>Shembull</i>	
<i>Pyetjet:</i>	<i>A B C D E F .....</i>
<i>Përgjigjet:</i>	<i>1 0 1 0 1 .....</i>

Më pas mësimdhënësi shtron një sërë pyetjesh (prej A deri në R) nga Lista A, dhe nxënësit i shënojnë përgjigjet e tyre në mënyrë individuale në formë të 1 ("po") ose 0 ("jo"). Mësimdhënësi u tregon nxënësve se edhe nëse kanë dyshime për ndonjërin nga përgjigjet e tyre, ata përsëri duhet të shënojnë përgjigjen të cilën ata mendojnë se është më e saktë.

<b>Lista A</b>	<b>Lista B</b>
A. A jeni grua?	A. A ndjeheni gjithmonë të lumtur?
B. A keni vizituar më shumë se një shtet të huaj?	B. A keni thonj në gishtat tuaj?
C. A ju pëlqen të luani disa sporte?	C. A jeni në gjendje të mendoni ndopak?
D. A luani në ndonjë instrument muzikor?	D. A u ka sjellë në jetë një nënë?
E. A keni sy bojëkafe?	E. A mund të fluturoni pa përdor asnjë pajisje (siç mund të fluturojë zogu)?
F. A janë të dy gjyshet tua akoma gjallë?	F. A mund të jetoni pa pirë asgjë?
G. A mbani syze?	G. A merrni frymë?
H. A ju pëlqen të qëndroni jashtë në natyrë?	H. A jetoni vazhdimisht nën ujë?
I. A jeni person mjaft i qetë?	I. A keni ndjenja të çfarëdo lloji?
J. A jeni goxha i gjatë (mbi mesataren)?	J. A është gjaku juaj i gjelbër?
K. A jeni person goxha i dëshpëruar (më shumë se mesatarja)?	K. A jeni rrëzuar ndonjëherë?
L. A ftoheni lehtë?	L. A mund të shikoni përmes mureve?
M. A ju pëlqen udhëtimi?	M. A mund të komunikoni me të tjerët?
N. A ju pëlqen të shkoni tek floktari?	N. A ju pëlqen moti i mirë?
O. A ju pëlqen të punoni me kompjuterë?	O. A do t'ju pëlqente të mos takoheshit me njerëz?
P. A frikoheni nga lartësitë?	P. A keni gjuhë?
Q. A preferoni ngjyrën kafe në vend të ngjyrës së kaltër?	Q. A mund të ecni në ujë (siç ecin disa insekte)?
R. A ju pëlqen vizatimi/pikturimi?	R. A ndjeheni ju ndonjëherë të lodhur?

Mësimdhënësi kërkon që një përfaqësues nga çdo grup të shënojë përgjigjet e tyre në Listën A në dërrasën e zezë. Mësimdhënësi pastaj kërkon që nxënësit të shikojnë përgjigjet e dhëna dhe shkurtimisht t'i krahasojnë ato me përgjigjet e tyre. A shohin ata dallime në mes të përgjigjeve? A mund t'i përmbledhin disa nga dallimet në mes tyre?

Mësimdhënësi pastaj kërkon që nxënësit të përgjigjen në serinë tjetër të pyetjeve, këtë herë të marrë nga Lista B. Sërish, nga përfaqësuesi i çdo grupi kërkohet që të shënojë përgjigjet e tyre në dërrasën e zezë, nën shkronjat e alfabetit.

Pse këtë herë nuk ka gati asnjë dallim në mes të grupeve? Mësimdhënësi i pyet nxënësit nëse ata mund të shtojnë më shumë gjëra që shumica prej tyre i kanë të përbashkëta.

Për aktivitetin shtesë, mësimdhënësi i jep çdo grupi një fletë të madhe të letrës dhe shënues (marker). Detyra e tyre është që:

1. Secili grup të gjejë tre shembuj të situatave, në të cilat është kënaqësi të jesh i ngjashëm me të tjerët. Tregoni arsyet pse mendoni se të qenit i ngjashëm është kënaqësi
2. Secili grup të gjejë tre shembuj të situatave, në të cilat është kënaqësi të jesh ndryshe nga njerëzit e tjerë. Tregoni arsyet pse mendoni se të qenit ndryshe është kënaqësi.

Nëse është e nevojshme, mësimdhënësi demonstroi se si një formë e të menduarit u jep strukturë rezultateve të nxënësve.

Situatat në të cilat është kënaqësi të jesh i ngjashëm	Pse?
a)	a)
b)	b)
c)	c)

Situatat në të cilat është kënaqësi të jesh ndryshe	Pse?
a)	a)
b)	b)
c)	c)

Pastaj mësimdhënësi kërkon që grupet të gjejnë tre shembuj të situatave në të cilat është e pakëndshme të jesh ndryshe nga të tjerët. Dhe sërish, ata duhet të japin arsyet pse mendojnë se kjo mund të jetë kështu. Çfarë ndjenjash krijon?

Situatat në të cilat është e pakëndshme të jesh ndryshe	Pse?
a)	a)
b)	b)
c)	c)

Pastaj mësimdhënësi i pyet nxënësit cilat grupe të njerëzve të “ndryshëm” ndonjëherë keqtrajtohen dhe nga kush bëhet kjo.

<b>Grupet e njerëzve të cilët ndonjëherë keqtrajtohen</b>	<b>Nga kush?</b>
a)	a)
b)	b)
c)	c)

Mësimdhënësi kërkon që çdo grup të paraqesë përgjigjet e tij. Për më tepër, klasa do të shqyrtojë se cilat të drejta mund të shkelen në rastet e paraqitura. Për këtë qëllim, grupeve u jepet një kopje e prospekteve për nxënës 5.2: Lista e të drejtave të njeriut.



## Mësimi 2

### Tregimi i Xhevahires

Si do të reagonim po të na ndodhte kjo neve?

<b>Objektivat e mësimnxënies</b>	Nxënësit vetëdijesohen për paragjykimet dhe diskriminimin në shoqëri. Nxënësit janë të aftë të kuptojnë pikëpamjet e viktimave të diskriminimit. Nxënësit janë në gjendje të reagojnë në situatat e diskriminimit.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Nxënësit komentojnë një rast të diskriminimit dhe atë e krahasojnë me situatën në shtetin e tyre.
<b>Burimet</b>	Kopje të prospekteve për nxënës 2.1 (me pyetje) për çdo nxënës.
<b>Metodat</b>	Punë në grupe bazuar në tekst.

### Të mësuarit konceptual

Diskriminimi është një formë e sjelljes shumë e përhapur në shoqëri. Në diskriminim nuk janë të përfshirë vetëm autoritetet, por gjithashtu edhe shumë organe dhe individë të tjerë. Duke filluar me një tregim të vërtetë të diskriminimit, mësimi u jep nxënësve mundësinë të reflektojnë në sjelljen e tyre.

## Mësimi

Mësimdhënësi mund të lexojë me zë një kopje të prospekteve për nxënës 2.1 apo t'u jep një kopje nxënësve që ata ta lexojnë vetë.

### Tregimi i Xhevahires

Xhevahirja, një grua rome, tregon se çka i ka ndodhur asaj:

*“Unë e pashë një vend pune si asistente e shitjes të shpallur në vitrinën e një dyqani rrobash. Ata kërkonin një punëtor ndërmjet moshës 18 dhe 23 vjeç. Unë i kam 19 vjet, kështu që hyra brenda dhe e pyeta menaxherin lidhur me këtë vend të punës. Ajo më tha që të shkoja sërish pas dy ditësh sepse nuk kishin aplikuar mjaft njerëz.*

*Unë shkova edhe dy herë të tjera dhe morra përgjigjen e njëjtë .Pothuaj një javë më vonë unë shkova sërish në atë dyqan. Shpallja e vendit të punës akoma ndodhej në vitrinë. Menaxheri ishte shumë i nxënë që të takohej me mua, veçse më thanë se vendi i lirë i punës ishte plotësuar.*

*Pasi u largova nga dyqani, isha shumë e mërzhitur dhe e pyeta një mike jo rome nëse mund të hynte brenda dhe të pyeste për vendin e punës. Kur ajo doli jashtë tha se i kishin thënë të shkonte për intervistë të hënën.”*

Pasi të gjithë nxënësit të kenë lexuar apo dëgjuar tregimin, mësimdhënësi i ndan nxënësit në grupe me katër apo pesë vetë dhe kërkon që ata të diskutojnë për pyetjet vijuese (prospektet e nxënësve i përfshijnë këto pyetje; nëse mësimdhënësi e ka prezentuar tregimin gojarisht, ai ose ajo duhet t'i shënojë pyetjet në dërrasën e zezë apo në tabelën shfletuese (flip chart)):

- 1 Si do të ndiheshit nëse ajo çka i ka ndodhur Xhevahire do t'ju ndodhte juve? Si do të reagonit ju nëse mikja juaj do t'ju tregonte se ajo është ftuar për intervistë?
- 2 Pse, sipas jush, menaxheri i dyqanit veproi në këtë mënyrë? A e konsideroni këtë një formë të diskriminimit? Pse (ose pse jo)?
- 3 Çka mund të bënte Xhevahirja për këtë? A mendoni se do të mund të ndryshonte situatën? Çka mund të bënin njerëzit tjerë në emër të saj?
- 4 A prisni ju që me ligj të bëhet diçka për një situatë të tillë? Çka duhet të parasheh ligji?
- 5 A mund të ndodhë kjo edhe në vendin tuaj? Nëse po, cilat grupe do të dëmtoheshin?

Mësimdhënësi kërkon përgjigjet fillestare nga grupet për këto pyetje. Kjo mund të bëhet duke i shtruar çdo grupi një pyetje apo duke kërkuar nga grupet përgjigje të shkurtra në më shumë se një pyetje.

Mësimdhënësi pastaj u tregon nxënësve se tregimi i Xhevahires ka ndodhur me të vërtetë, para më shumë se një dekadë, dhe se më vonë, kur e kanë pyetur për sjelljen e tij, menaxheri i dyqanit tha:

### Përgjigjja e menaxherit

*“Mendova se Xhevahires do t'i dukej vështirë të punonte këtu, për shkak të distancës së largët, ku ajo do të duhej të udhëtonte për në punë çdo ditë. Do të ishte një udhëtim prej tetë milje në dy autobusë . Është shumë vështirë të drejtosh dyqanin nëse stafi gjithmonë vonohet. Unë do të preferoja më shumë të zgjedh dikë nga ky rajon. Personi të cilin e pranova për këtë vend të punës mu duk person i duhur.”*

Mësimdhënësi u tregon nxënësve se në Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut (neni 14) thuhet se: “Sigurohet gëzimi i të drejtave dhe lirive të parapara në këtë Konventë pa diskriminim në asnjë bazë siç është seksi, raca, ngjyra, gjuha, religjioni, mendimi politik apo tjetër, prejardhja nacionale apo shoqërore, shoqërimi me një pakicë nacionale, prona, lindja apo ndonjë status tjetër”; dhe se në nenin 2 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut thuhet: “Çdokush ka të drejtë të gëzojë të gjitha të drejtat dhe liritë e parapara në këtë Deklaratë, pa dallim të çfarëdo lloji, siç është raca,

ngjyra, gjuha, religjioni, mendimi politik apo tjetër, prejardhja nacionale apo shoqërore, prona, lindja apo ndonjë status tjetër."

Pastaj mësimdhënësi i pyet nxënësit se çka nënkuptohet me këto tekste në lidhje me rastin e Xhevahires. Për ta përmbyllur mësimin, mësimdhënësi u tregon nxënësve se si ka përfunduar rasti i Xhevahires në të vërtetë.

### **Konkludimi i tregimit të Xhevahires**

"Xhevahirja e paraqiti rastin e saj në një gjykatë speciale evropiane, që e zbaton ligjin mbi diskriminimin. Gjykata u pajtua se ndaj saj ishte bërë diskriminim. Ishin marrë në pyetje disa njerëz të tjerë që jetonin shumë larg dyqanit. Vajza e cila u punësua në këtë detyrë ishte vetëm 16 vjet, e racës së bardhë, dhe jetonte në largësi të njëjtë nga dyqani sikurse Xhevahirja. Dyqani duhej t'i paguante Xhevahires ca para për lëndimin e ndjenjave të saj."

Në vazhdim, mësimdhënësi kërkon që nxënësit t'i shkruajnë një letër menaxherit të dyqanit apo kryetarit të qytetit. Ai/ajo duhet t'i ndihmojë ata që të shkruajnë duke marrë parasysh pikëpamjet e tyre personale dhe opinionet e Gjykatës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut. Është me rëndësi që e tërë klasa t'i shoh këto shkresa, ashtu që të bëhen diskutime edhe jashtë orëve të zakonshme të shkollës.

### Mësimi 3

## Barazia në mes të meshkujve dhe femrave

### Si duhet t'i trajtojmë meshkujt dhe femrat?

<b>Objektivat e mësimnxënies</b>	Nxënësit vetëdijesohen për diskriminimin në baza gjinore në shoqëri. Nxënësit janë në gjendje të kuptojnë pikëpamjet e viktimave të diskriminimit në baza gjinore. Nxënësit kanë mundësi të reagojnë në situata të diskriminimit.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Nxënësit gjykojnë se si ata, dhe shoqëria në përgjithësi, i trajtojnë femrat në shoqërinë e tyre.
<b>Burimet</b>	Një kopje të një tregimi nga prospektet e nxënësve 2.2 për çdo grup. Një fletë e madhe e letrës dhe shënjes (marker) për çdo grup.
<b>Metoda</b>	Grupe të vogla, diskutime dhe prezentime.

### Kuti informacioni

Do të kalojë një kohë shumë e gjatë para se meshkujt dhe femrat të trajtohen si qenie të barabarta njerëzore me ligj dhe në jetën e tyre të përditshme. Situatat e ndryshme në familje, në shkollë dhe në punë ofrojnë mundësi për rritjen e bashkëndjeshës për këto çështje dhe thellimin e mendimeve se si duhet trajtuar ato. Ky mësim shërben, gjithashtu, edhe si një ftesë për të bërë ndryshime të disa praktikave në klasë apo në shkollë.

## Mësimi

Klasa ndahet në grupe me katër apo pesë nxënës. Çdo grupi i jepet njëri nga tregimet e dhëna në prospektet për nxënës 2.2. Pasi të kenë përfunduar leximin, nxënësit ftohen të diskutojnë për pyetjet e dhëna në çdo tregim.

Mësimdhënësi pastaj bën një komentim përcjellës për secilin tregim, duke kërkuar nga raportuesi i çdo grupi të paraqesë një përmbledhje të shkurtër të tregimit të tyre, dhe të paraqesë rezultatet e diskutimeve të grupit.

Pasi që të bëhet kjo, mësimdhënësi kërkon që nxënësit të lexojnë me kujdes tabelën dhe tekstin në dërrasën e zezë me kujdes, dhe pastaj të japin dy shembuj të dallimeve të seksit, dhe dy shembuj tjerë të dallimeve të gjinisë, për të siguruar që të gjithë nxënësit i kuptojnë përkufizimet e dhëna.

Seksi	Gjinia
I përcaktuar biologjikisht	E përkufizuar në marrëdhënie shoqërore
Statik, nuk mund të ndryshojë	Dinamike, mundësi për t'u ndryshuar
<i>“Seksi u referohet ndryshimeve të dallueshme në mënyrë të natyrshme bazuar në karakteristikat biologjike të të qenit femër apo mashkull.”</i>	<i>“Gjinia është koncept që i referohet ndryshimeve shoqërore, për dallim nga ato biologjike, në mes të meshkujve dhe femrave që ne i kemi mësuar, të cilët me kohë pësojnë ndryshime dhe që ndryshojnë shumë në bazë të faktorëve historik, kulturor, tradicional, gjeografik, religjioz, social dhe ekonomik.”</i>

Pasi të kthehen nëpër grupet e tyre, nxënësve u jepet një fletë e madhe e letres dhe marker. Ata tani diskutojnë nëse mendojnë se shkolla e tyre mbështet apo jo barazinë gjinore. Nëse ata mendojnë se po, duhet të paraqesin pesë shembuj të cilët e mbështesin mendimin e grupeve të tyre. Por, nëse përgjigjja e tyre është “jo”, ata duhet të shënojnë deri në pesë gjëra të cilat mund të bëhen për të përkrahur barazinë gjinore në shkollën e tyre.

Nga çdo grup kërkohet që të paraqesin konstatimet e tyre.

Nëse mësimdhënësi dëshiron të zgjerojë këtë aktivitet në një projekt pune, ai ose ajo duhet të kërkojë nga nxënësit të zgjedhin një apo dy ide dhe të përpilojnë një plan për t'i zbatuar këto në shkollë. Plani duhet të përfshijë objektivin e përgjithshëm, hapat e ndryshëm që duhet të ndërmerren, njerëzit përgjegjës dhe planin kohor.

## Shembull i një plani

Objektivi i përgjithshëm: .....		
Çka duhet bërë?	Kush do ta bëjë?	Kur duhet të jetë i gatshëm?

## Mësimi 4

### Drejtësia shoqërore

#### Si duhet të përballemi me padrejtësitë?

<b>Objektivat e mësimnxënies</b>	Nxënësit vetëdijesohen për problemet që lidhen me drejtësinë shoqërore.
<b>Detyrat e nxënësve</b>	Nxënësit diskutojnë çështje të ndarjes së drejtësisë. Nxënësit rishyrtojnë tërë njësinë.
<b>Burimet</b>	(Sipas dëshirës) Kopje të prospekteve për nxënës 2.3 dhe pyetjet.
<b>Metoda</b>	Diskutime të bazuara në tekstet, punë në çifte, të menduarit kritik.

### Kuti informacioni

Në shoqërinë tonë, nuk ka marrëveshje të përgjithshme se çka në të vërtetë do të thotë drejtësia shoqërore. Tregimi i përdorur në këtë mësim synon të ndihmojë nxënësit për të reflektuar mbi parimet themelore në të cilat duhet të rrënjohet drejtësia shoqërore, duke treguar në të njëjtën kohë edhe kompleksitetin e kësaj çështjeje.

## Mësimi

Mësimdhënësi u shpjegon nxënësve se ai/ajo do t'ju jep një tregim në katër pjesë, dhe pas leximit të çdo pjese do të zhvillohen diskutime. Përndryshe, mësimdhënësi mund ta lexojë tregimin edhe me zë.

Pastaj, mësimdhënësi e ndan klasën në çifte, dhe çdo çifti i jep pjesën e parë të prospekteve për nxënës 2.3. Mësimdhënësi mund ta lexojë me zë, të kërkojë që këtë ta lexojë një nxënës tjetër, ose nxënësit mund ta lexojnë në qetësi.

### Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit: pjesa e parë

*“Kaloi më shumë se një orë ndërmjet alarmit të parë dhe fundosjes së anijes lundruese 'Mbretëresha Maddy'. Kështu udhëtarët mundën të vetorganizoheshin sadopak para se të hipnin në anijet e shpëtimit. Një stuhi e fuqishme kishte bërë që anija të përplasej me një anije-cisternë naftë duke shkaktuar kështu mbytjen e anijes.*

*Pas një gjysmë dite, disa nga anijet e shpëtimit zbarkuan në një ishull të vogël shkëmbor. Ishulli kishte formë vezake, ishte i gjatë rreth 1.5 km e i gjerë sa gjysma e kësaj gjatësie, dhe pjesërisht ishte i mbuluar me drunjtë të harlisur. Nuk kishte ndonjë ishull tjetër përbrenda një largësie të arsyeshme. Ky ishull me mjaft diell, nuk ishte i banuar, përveç familjes Richalone, të cilët jetonin në një vilë luksoze në majë të bregut dhe e zotëronin tërë ishullin.*

*Vite me parë, kjo familje ishte vendosur në ishull, duke mos mbajtur pothuajse fare kontakt me botën e jashtme; ata thjesht rregulluan furnizimin mujor me ushqim të freskët, me benzinë dhe të mira të tjera që u nevojiteshin. Jeta e tyre ishte e organizuar mirë: ata prodhonin energjinë e tyre elektrike, ishin në gjendje të blinin ushqim e pije të mjaftueshme dhe kishin të gjitha komoditetet bashkëkohore që ata i dëshironin. Në të kaluarën, pronari kishte qenë një afarist shumë i suksesshëm. Pas një konflikti me administratën rreth një çështjeje tatimi, ai u zhgënjye nga jeta dhe vendosi që prej asaj kohe t'ju shmange kontakteve me botën e jashtme.*

*Pronari i vilës i kishte vëzhguar anijet e shpëtimit duke u zbarkuar në ishullin e tij të bukur dhe ju kishte afruar të mbijetuarve.”*

Mësimdhënësi pastaj sqaron se çështjen e parë të cilën nxënësit duhet ta trajtojnë është nëse, për mendimin e tyre, pronari i ishullit është moralisht i obliguar që t'i lejojë këta njerëz të rrinë në ishullin e tij. Për t'i ndihmuar nxënësit të arrijnë në një përfundim, mësimdhënësi do t'ju lexojë atyre disa formulime (të paraqitura më poshtë) dhe secila palë duhet të vendosë se me cilin/cilat formulim/e ata pajtohen dhe pse. Nxënësit i shtjellojnë në çifte dhe i shënojnë përgjigjet e tyre.

- A. Pronari mund të mos pranojë që të mbijetuarit të qëndrojnë në ishullin e tij.
- B. Pronari mund të mos i pranojë të mbijetuarit të qëndrojnë në ishullin e tij, por me kusht që atyre t'ju sigurojë ushqimin edhe pijet e nevojshme.
- C. Pronari mund të mos i pranojë të gjithë ata që nuk janë në gjendje të paguajnë (me para, xhevahir apo përmes punës) të qëndrojnë në ishullin e tij.
- D. Pronari duhet t'i lejojë njerëzit të qëndrojnë në ishullin e tij për sa kohë të jetë e nevojshme. Njerëzit e mbijetuar kanë obligim moral që të respektojnë intimitetin dhe gjërat personale të pronarit.
- E. Pronari duhet t'ju lejojë të mbijetuarve hyrje të pakushtëzuar në ishull dhe ata t'i konsiderojë si bashkëpronar.

Mësimdhënësi mund të merr reagimin (informatën kthyesë) e klasës, për shembull duke pyetur pyetje të tilla si “Sa prej juve kanë zgjedhur formulimin A?” “Sa kanë zgjedhur formulimin B?” “Pse?”

Më pastaj mësimdhënësi shpërndan pjesën e dytë të rrëfimit.

## Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit: pjesa e dytë

*“Pronari i ishullit vendosi t’i lejojë të mbijetuarit të qëndrojnë në ishull për një kohë. Ai priste që ata të paguajnë për shërbimin dhe ushqimin nga rezervat e tij. Për sa kohë që kishte ushqim të mbetur nga anija, ai refuzoi që t’ju shiste atyre ndonjë gjë.*

*Ishin 13 të mbijetuar nga anija e mbytur. Ishte Viktori, gruaja e tij shtatzënë Josepha dhe dy fëmijët e tyre (3 dhe 7 vjeçar). Abramovitch, 64, ishte një tregtar i pasur i xhevahireve. Ai ishte pjesëtari më i moshuar dhe nuk kishte ndonjë farefis apo miq. Ai mbarte me vete një koleksion me unaza ari, diamante dhe gjerdanë të tjerë të çmuar. John, Kate, Leo dhe Alfred ishin katër shokë të rinj, të cilët ishin të fuqishëm, të shëndetshëm dhe shumë të zotë. Ata kishin jetuar së bashku në një shtëpi alternative në komunitet dhe e kishin rinovuar vetë shtëpinë ku jetonin.*

*Maria, një juriste që punonte me gjysmë orar në një universitet, ecte shumë ngadalë për shkak të problemeve me këmbën dhe ijen e saj të majtë (si pasojë e një aksidenti). Ajo shoqërohej nga Max-i, asistenti i saj në universitet, pasi që udhëtonin për në SHBA për të mbajtur një ligjëratë në një konferencë dhe për të shqyrtuar publikimin e një libri me një botues. Që të dy kishin specializuar në të drejtën penale, por jo edhe të talentuar në shkrim. i fundit, por jo më i pakti, ishte Marko dhe e dashura e tij Vicky, që të dy anëtarë të ekuipazhit të varkës të cilët, në momentin e fundit, kishin marrë aq sa kishin mundur të mbartin nga depoja e anijes: kuti me ushqime, biskota, vaj dhe disa tiganë për gatim. Të gjithë këta të mbijetuar kishin ca para, por kryemarinari Marko mbarte një shumë të madhe, të cilën ai e kishte vjedhur nga një banesë në portin e fundit ku ishin ndalur.*

*Në ishull kishte një strehë të vogël e të vjetër në faqe të bregut, fare afër detit. Kishte vetëm një dhomë që mund të shërbente si strehë e thjeshtë për dy a tre njerëz.”*

Mësimdhënësi pastaj sqaron se secila palë duhet të vendosë se kush, për mendimin e tyre, duhet të lejohet të përdorë strehën. Mësimdhënësi u lexon atyre formulimet në vazhdim dhe kërkon nga nxënësit që të diskutojnë në çifte se me cilën/cilat formulime ata pajtohen, pse dhe nëse kanë ndonjë zgjidhje tjetër:

- A. Gruaja shtatzënë dhe fëmijët.
- B. Katër shokët e rinj, që janë të vetmit që mund ta rinovojnë atë.
- C. Tregtari i gjerdanëve, që paguan për të (duke lejuar kështu të tjerët të blejnë ca ushqime).
- D. Kryemarinari dhe e dashura e tij, me kusht që ata të ndajnë ushqimin e tyre me gjithë njerëzit e tjerë.
- E. Juristja, e cila është në gjendje të veprojë si ndërmjetësues dhe të zgjidhë zënkat në mes të të mbijetuarve.

Pas raportimit të nxënësve, u shpërndahet pjesa tjetër e rrëfimit.

## Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit: pjesa e tretë

*“Të mbijetuarit duhet gjithashtu të vendosin se çfarë të bëjnë me rezervat e ushqimit që i kishte marrë me vete kryemarinari, dhe të cilat ai nuk kishte ndërmend t’i ndante. Në fakt, ndarja nënkuptonte zvogëlimin e mundësive për mbijetesën e tij dhe të dashurës së tij.”*

Tani palëve u kërkohet të gjykojnë se kush duhet të merr ushqimin nga furnizimet e anijes. Mësimdhënësi u lexon përsëri formulimet dhe kërkon nga ata që të shqyrtojnë dhe të vendosin se me cilën/cilat formulime ata pajtohen, pse dhe nëse shohin ndonjë zgjidhje tjetër.

- A. Kryemarinarit duhet t’i lejohet që të mbajë ushqimin për vete dhe për të dashurën e tij.
- B. Ushqimi në dispozicion duhet të shpërndahet, në mënyrë të barabartë, në mes të gjithë të të mbijetuarve.
- C. Ushqimi në dispozicion mund të blihet nga ofruesi më i lartë (qoftë me para, të mira apo shërbime).

Pas raportimit, shpërndahet pjesa e fundit e rrëfimit.



## Informacionet e prapaskenës vetëm për mësimdhënësit: pjesa e katërt

Në çifte, nxënësit diskutojnë se kush duhet ta pyes pronarin për ushqim dhe se si duhet të bëhet kjo.

*“Të mbijetuarit vendosin se ushqimi duhet të ndahet pa ndonjë kompensim. Ata e detyruan Markon që t’i dorëzojë rezervat e tij duke joshur ndjesinë e tij për obligim moral. Pas afërsisht një jave nuk kishte ushqim të mbetur, dhe zgjidhja e vetme ishte të provonin të merrnin ushqim nga pronari i vilës.”*

Më tej mësimdhënësi u lexon nxënësve formulimet në vijim dhe pyet se me cilën/cilat nga ato pajtohen, pse dhe nëse shohin zgjidhje tjetër.

- A. Secili person duhet të diskutojë individualisht kushtet e tregtisë me pronarin (pagesën me para, gur të çmuar apo punë). Në këtë rast, probleme do të kenë veçanërisht familja me fëmijët dhe juristja me asistentin e saj.
- B. Të gjitha burimet në dispozicion (gurët e çmuar, paratë) duhet të ndahen në mes të gjithë njerëzve, pavarësisht nga pronari i parë. Ushqimi i blerë në këtë mënyrë duhet të shpërndahet në sasi të barabarta. Veç kësaj, individualisht mund të blihet ushqim plotësues në këmbim të punës.
- C. Njësoj sikurse B, por gjithkush supozohet të punojë në nivel me aftësitë e tij ose saj dhe të ndajë me të tjerët ushqimin që e fiton në këtë mënyrë.
- D. Tregtari i gjerdanëve lejohet që të blejë gjithçka që pronari është i gatshëm të shesë dhe t’i “ndihmojë“ të tjerët me pako ushqimi.

Pas raportimit, mësimdhënësi mund të kryesojë diskutimin në klasë me qëllim që nxënësit t’i ndihmojë të zbatojnë rrëfimin në botën reale:

A njihni situata të ngjashme në shoqërinë tonë?

- A. ... në lagjen tënde ose në familje?
- B. ... në vendin tënd?
- C. ... në përmasa globale?

Cilat rrethana reale që ti i di të godasin si rrethana të padrejta sa i përket ndarjes së ushqimit, ujit, banimit, etj.?

- A. ... në lagjen tënde ose në familje?
- B. ... në vendin tënd?
- C. ... në përmasa globale?

Pse?

Në fund të këtij mësimi, duhet të ketë një diskutim për konceptet themelore të kësaj njësie. Mësimdhënësi mund të vendosë të shtojë një mësim shtesë. Për të filluar, mësimdhënësi mban një ligjëratë të shkurtër duke përdorur informacionet qendrore të barazisë dhe diversitetit nga kjo njësi. Ai/ajo madje mund të përgatisë prospekte me përkufizimet e ndryshme. Nxënësit pastaj do të reflektojnë për katër mësimet në grupe të vogla: Çka kanë diskutuar ata? Çka kanë mësuar ata? Për cilat pyetje të reja janë vetëdijësuar ata? Ata japin sugjerime se si duhet reaguuar në situata të pabarazisë në jetën e tyre.

## Prospektet për nxënës 2.1

### Tregimi i Xhevahires

Xhevahirja, një grua rome, tregon se çka i ka ndodhur asaj:

*“Unë e pashë një vend pune, asistente e shitjes të shpallur në vitrinën e një dyqani rrobash. Ata kërkonin një punëtor ndërmjet moshës 18 dhe 23 vjeç. Unë i kam 19 vjet, kështu që hyra brenda dhe e pyeta menaxherin lidhur me këtë vend të punës. Ajo më tha që të shkoja sërish pas dy ditësh sepse nuk kishin aplikuar mjaft kandidatë.*

*Unë shkova edhe dy herë të tjera dhe morra përgjigjen e njëjtë. Pothuaj një javë më vonë unë shkova sërish në atë dyqan. Shpallja e vendit të punës akoma ndodhej në vitrinë. Menaxheri ishte shumë i nxënë që të takohej me mua, veçse më thanë se vendi i lirë i punës ishte plotësuar.*

*Pasi u largova nga dyqani, isha shumë e mërziur dhe e pyeta një mike jo rome nëse mund të hynte brenda dhe të pyeste për vendin e punës. Kur ajo doli jashtë tha se i kishin thënë të shkonte për intervistë të hënën.”*

### Pyetjet

1. Si do të ndiheshit nëse ajo çka i ka ndodhur Xhevahires do t’ju ndodhte juve? Si do të reagonit ju nëse mikësja e juaj do t’ju tregonte se ajo është ftuar për intervistë?
2. Pse, sipas jush, menaxheri i dyqanit veproi në këtë mënyrë? A e konsideroni këtë një formë të diskriminimit? Pse (ose pse jo)?
3. Çka mund të bënte Xhevahirja për këtë? A mendoni se do të mund të ndryshonte situatën? Çka mund të bënin njerëzit tjerë në emër të saj?
4. A prisni ju që me ligj të bëhet diçka për një situatë të tillë? Çka duhet të parasheh ligji?
5. A mund të ndodhë kjo edhe në vendin tuaj? Nëse po, cilat grupe do të dëmtoheshin?

## Prospektet për nxënës 2.2

### Meshkujt dhe femrat: tregimi

#### Tregimi 1

*“Mua më ka ndodhur shumë herë. Pas darkës, nëna ime pret që fëmijët e saj t’i çojnë të gjitha pjatat dhe tavat në kuzhinë, ta pastrojnë tavolinën, t’i lajnë enët, të sigurojnë se çdo gjë është vënë nëpër raftet dhe se e tërë kuzhina është e rregulluar dhe e pastër. Edhe njëherë, dy vëllezërit e mi, edhe pse më të vjetër se unë, më thanë se kjo nuk ishte punë për ata, dhe se duhej ta bëja unë, mu për shkak se unë jam vajzë. Këtë herë unë nuk protestova, sepse isha shumë e zemëruar. Ju ankova babait tim, por ai më tha se ishte mirë që unë të bëja pak përvojë, dhe se ishte përgatitje e mirë për t’u bërë shtëpiake.”*

#### Pyetjet

1. A mund të përfytyroni që kjo të ndodhë në familjen tuaj?
2. Përfytyroni sikur kjo vajzë të jeni ju: çka do të dëshironit t’ju thoni vëllezërve tuaj? Po babait tuaj?
3. A pajtoheni ju me tekstin e nenit 1 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut? Si zbatohet kjo në tregimin e lartpërmendur?

*“Të gjitha qeniet njerëzore kanë lindur të lirë dhe të barabartë për sa i përket dinjitetit dhe drejtave të tyre”.*

#### Tregimi 2

*“Gjashtë djem qëndronin rreth meje në oborrin e shkollës. Ata m’i kishin ngulur sytë dhe më ngacmonin. Ata thanë: ‘Hej djema, a jeni të sigurt se kjo është vajzë? A ta vërtetojmë këtë?’ Pastaj njëri prej tyre m’u afrua, duke tentuar të më prekë. Por mu në atë moment drejtori i shkollës hyri në oborr dhe djemtë u larguan.”*

#### Pyetjet

1. A mund të parafytyroni që kjo të ndodhë në apo rreth shkollës suaj? Jepni shembuj.
2. Përfytyroni sikur kjo vajzë të jeni ju – çka do të dëshironit t’ju thoni këtyre djemve?
3. Përfytyroni sikur një djalë tjetër nga distanca pa se çka po ndodhte. A do të duhej të ndërhynte ky djalë? Pse/pse jo? Si do të kishte mundur të ndërhynte ai?
4. A mendoni se kjo që ndodhi është “ngacmim seksual” sipas përkufizimit vijues?

*“Ngacmimi seksual është çdo sjellje e cila me fjalë, veprim ose efekt psikologjik të natyrës seksuale, qoftë për nga qëllimi apo ndikimi, dëmton dinjitetin e personit apo shkakton kërcënim, armiqësi ose sjellje të caktuar, situata frikësimi apo të ngjashme, dhe që motivohet nga fakti se i përket seksit tjetër apo orientimit tjetër seksual, dhe që për viktimën paraqet sjellje të papërshtatshme fizike, verbale, sugjestive apo tjetër.”*

#### Tregimi 3

*“Si inxhinier i ri, aplikova në vendin e punës menaxher i mirëmbajtjes teknike në një fabrikë me materiale ndërtimore. Mua më ftuan të marr pjesë në testet e përgjithshme, ato teknike dhe psikologjike, së bashku me 24 kandidatë të tjerë, të gjithë meshkuj përveç meje. Pas kësaj faze, pesë kandidatë ishin përzgjedhur për intervistë me menaxherin e përgjithshëm. Edhe pse sipas testeve isha radhitur e treta, unë nuk isha në mesin e tyre (Këtë informacion e kam marrë në mënyrë shumë*

*sekrete nga një mik i imi që punon në zyrën e administrimit të personelit). Duke mos e përmendur këtë informacion, unë tentova ta thirr menaxherin e përgjithshëm. Kur arrita të bisedoj me të, e pyeta nëse e kishin marrë parasysh faktin se jam femër. Ai e mohoi këtë, por tha se duhet pranuar se gratë shpesh mbesin shtatzënë pas disa vitesh, dhe se për vende të caktuara pune kjo shkakton probleme të vazhdimësisë së punës. Ai gjithashtu tha se, sidomos për këtë punë, do të ishte shumë vështirë për një grua, meqë të gjithë punëtorët në ekipin teknik ishin burra, dhe se ata sillen mjaft vrazhdë. Unë duhet të konsiderohem fatlume pse nuk jam përzgjedhur.”*

## **Pyetjet**

1. A mund të përfytyroni që kjo të ndodhë në një kompani të rajonit tuaj?
2. Përfytyroni sikur kjo grua jeni ju: çka do të dëshironit t’i thoni menaxherit të përgjithshëm?
3. A mendoni se, në këtë rast, menaxheri i përgjithshëm vepron në kundërshtim me ligjin në vendin tuaj? Nëse po, si do ta dëshmonit këtë?

*“Të gjitha format e diskriminimit në bazë të gjinisë në procesin e punësimit, në shpalljen e vendeve të lira të punës, në procedurat e përzgjedhjes, punësimit dhe shkarkimit janë në kundërshtim me dispozitat ligjore.”*

## Prospektet për nxënës 2.3

### Mbytja e anijes

#### Pjesa një

“Kaloj më shumë se një orë ndërmjet alarmit të parë dhe fundosjes së anijes lundruese ‘Mbretëresha Maddy’. Kështu udhëtarët mundën të organizoheshin sadopak para se të hipnin në anijet e shpëtimit. Një stuhi e fuqishme kishte bërë që anija të përplasej me një anije-cisternë naftë duke shkaktuar kështu mbytjen e anijes.

Pas një gjysmë dite, disa nga anijet e shpëtimit zbarkuan në një ishull të vogël shkëmbor. Kishte formë vezake, i gjatë rreth 1.5 km e i gjerë sa gjysma e kësaj gjatësie dhe ishte i mbuluar pjesërisht me drunjtë të harlisur. Nuk kishte ndonjë ishull tjetër përbrenda një largësie të arsyeshme. Ky ishull me mjaft diell, nuk ishte i banuar, përveç familjes Richalone, të cilët jetonin në një vilë luksoze në majë të bregut dhe e zotëronin tërë ishullin.

Vite me parë, kjo familje ishte vendosur në ishull, duke mos mbajtur pothuajse fare kontakt me botën e jashtme; ata thjesht rregulluan furnizimin mujor me ushqim të freskët, me benzinë dhe gjëra të tjera që u nevojiteshin. Jeta e tyre ishte e organizuar mirë: ata prodhonin energjinë e tyre elektrike, ishin në gjendje të blinin ushqim e pije të mjaftueshme dhe kishin të gjitha komoditetet bashkëkohore që ata i dëshironin. Në të kaluarën, pronari kishte qenë një tregtar shumë i suksesshëm. Pas një konflikti me administratën rreth një çështjeje tatimi, ai u zhgënjye nga jeta dhe vendosi që prej asaj kohe t’ju shmangte kontakteve me botën e jashtme.

Pronari i vilës i kishte vëzhguar anijet e shpëtimit duke u zbarkuar në ishullin e tij të bukur dhe ju kishte afruar të mbijetuarve.”

#### Pjesa dy

“Pronari i ishullit vendosi t’i lejojë të mbijetuarit të qëndrojnë për një kohë në ishull. Ai priste që ata të paguajnë për shërbimin dhe ushqimin nga rezervat e tij. Për sa kohë që kishte ushqim të mbetur nga anija, ai refuzoi që t’ju shiste atyre ndonjë gjë.

Ishin 13 të mbijetuar nga anija e mbytur. Ishte Viktori, gruaja e tij shtatzënë Josepha dhe dy fëmijët e tyre (3 dhe 7 vjeçar). Abramovitch, 64, ishte një tregtar i pasur i gjerdanëve. Ai ishte pjesëtari më i moshuar dhe nuk kishte ndonjë farefis apo miq. Ai mbarte me vete një koleksion me unaza ari, diamante dhe gjerdanë të tjerë të çmuar. John, Kate, Leo dhe Alfred ishin katër shokë të rinj, të cilët ishin të fuqishëm, të shëndetshëm dhe shumë të zotë. Ata kishin jetuar së bashku në një shtëpi alternative në komunitet dhe e kishin rinovuar vetë shtëpinë ku jetonin.

Maria, një juriste që punonte me gjysmë orarë në një universitet, ecte shumë ngadalë për shkak të problemeve me këmbën dhe ijën e saj të majtë (si pasojë e një aksidenti). Ajo shoqërohej nga Max, asistenti i saj në universitet, pasi që po udhëtonin për në SHBA për të mbajtur një ligjëratë në një konferencë dhe për të diskutuar botimin e një libri me një botues. Që të dy kishin specializuar në të drejtën penal, por jo edhe të talentuar në shkrim. I fundit por jo më pak i rëndësishëm, ishte Marko dhe e dashura e tij Vicky, që të dy anëtarë të ekuipazhit të varkës të cilët, në momentin e fundit, kishin marrë aq sa kishin mundur të mbartin nga depoja e anijes: kuti me ushqim, biskota, vaj dhe disa tiganë për gatim. Të gjithë këta të mbijetuar kishin ca para, por kryemarinari Marko mbarte një shumë të madhe, të cilën ai e kishte vjedhur nga një banesë në portin e fundit ku ishin ndalur.

Në ishull kishte një strehë të vogël e të vjetër në faqe të bregut, fare afër detit. Kishte vetëm një dhomë që mund të shërbente si strehë e thjeshtë për dy a tre njerëz.”

## **Pjesa e tretë**

“Të mbijetuarit duhet të vendosin gjithashtu se çfarë të bëjnë me rezervat e ushqimit që i kishte marrë me vete kryemarinari, dhe të cilat ai nuk kishte ndërmend t’i ndante. Në fakt, ndarja nënkuptonte zvogëlimin e mundësive për shpëtim të tij dhe të dashurës së tij.”

---

## **Pjesa e katërt**

“Të mbijetuarit vendosin që ushqimi duhet të ndahet pa ndonjë kompensim. Ata e detyruan Markon që t’i dorëzojë rezervat e tij duke joshur ndjesinë e tij për obligim moral. Pas afërsisht një jave nuk kishte ushqim të mbetur dhe zgjidhja e vetme ishte të provonin të merrnin ushqim nga pronari i vilës.”